



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr 743 prot

Vlorë më 28/03 /2018

VENDIM

Nr. 4 datë 21/03 /2018

**“PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR PROGRAM BUXHETIN
AFAT - MESËM 2019-2021”**

Këshilli i Qarkut Vlorë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga *Grupi i Menaxhimit Strategjik*, për hartimin e tavaneve përgatitore për PBA 2019-2021, të Këshillit të Qarkut Vlorë, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore,, neni 41, pika1, neni 83, pika ç.
- Ligjin nr.68 dt.2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore,, neni 33, pika 1.
- Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, me ndryshimet e bëra,,.
- Ligji nr. 11/2017 “Për buxhetin e vitit 2018 ,, neni 16.
Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit,,.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.6/1, dt. 28.02.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor afat - mesëm 2019-2021,,.

V E N D O S I:

1. Të miratojë tavanet përgatitore për përgatitjen e Programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 :
 - Planin e transfertës së pakushtëzuar
 - Planin e transfertës së kushtëzuar
 - Planin e të ardhurave të Këshillit të Qarkut
2. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria Ekonomike & Shërbimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit në Këshill.

Planet e tavaneve përgatitore sipas tabelës bashkëlidhur.

Tavanet Përgatitore të PBA 2019-2021

Transferta e pakushtëzuar

Këshilli i Qarkut

në lekë

2019	2020	2021
38.474.467	39.276.018	40.077.570

Transferta e Kushtëzuar

Funksion i deleguar - DAMT

në lekë

2019	2020	2021
6.987.000	7.126.740	7.269.755

Transferta e Kushtëzuar

Shërbimet e Qendrë Sociale Vatra

në lekë

2019	2020	2021
9.225.000	9.409.500	9.597.690

Të ardhura të planifikuara

Këshilli i Qarkut

në lekë

2018	2019	2020
12.323.640	12.570.113	12.821.515

TOTALI

në lekë

2019	2020	2021
67.010.107	68.382.371	69.766.530

Shpallur nga Prefekti Qarkut Vlorë, me nr. _____ prot. datë _____. 2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 443 / prot
1

Vlorë më dt 28/03 / 2018

RAPORT

PËR HARTIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR PROGRAM BUXHETIN AFATMESËM 2019 -2021.

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “ Për Veteqeverisjen vendore ”, në ligjin nr. 68/2017 “ Për Financat e vetëqeverisjes vendore ”, në udhëzimin nr 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “ Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave nr 6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e tavaneve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”, Grupi i Menaxhimit Strategjik, kryesuar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut ju paraqet raportin mbi vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2019-2021 sipas strukturës së mëposhtme:

I. Organizimi i punës për hartimin e PBA-së 2019-2021

1. Ngritja e grupit të punës

Me urdhër nr 5 datë 03.01.2018 “Për miratimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik” nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Qarkut u ngrit Grupi i Menaxhimit Strategjik për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe përgatitjen e projekt buxhetit afatmesëm me ndarjen sipas programeve të Këshillit të Qarkut. Grupi i Menaxhimit Strategjik do të mbështetet në kalendarin e programit buxhetor afatmesëm miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 78 datë 20.12.2017, për të vepruar sipas strukturave përkatëse me qëllim realizimin e çdo detyre sipas afateve të përcaktuara në vendim.

2. Ndarja e kuotave sipas programeve

Nën drejtimin e Kryetarit të GMS në datë 12 Janar 2018 u organizua takimi i grupit për planifikimin e buxhetit për vitet 2019-2021, duke marrë në analizë realizimin e buxhetit në vitet 2016 dhe 2017, zbatimin për vitin 2018 dhe planifikimin për vitet 2019-2021. Në takim u diskutuan vlerat për transfertën e pakushtëzuar, transfertat e kushtëzuara dhe të ardhurat e realizuara sipas viteve të shprehura në tabelën e mëposhtme.

Programi	Emertimi i të Ardhurave	Fakti 2016	Fakti 2017	Plani për vitin 2018
01110	Të ardhurat e veta	11.876.712	10,182.595	12.082.000
01110	Transferta e pakushtëzuar Trashëguar	10.688.279	9.642.367	21.546.116
01110	Transf. të kushtëz. F. Zhvillim I Rajoneve	23.823.206	0	0
01110	Të ardhurave të trashëguara	4.117.996	4.795.174	8.083.015
01110	Transferta e pakushtëzuar	35.240.503	36.054.622	37.672.916
01160	Transferta të kushtëzuara DAMT	7.055.000	7.020.000	6,850,000
01160	Shpërblim i Menjehershëm	0	280.000	0
10430	Transferta të kushtëzuara Shërbimi Social	6.189.967	9.043.620	4.521.810
	Të ardhurat gjithsej	98.991.663	77.018.378	83.905.857

Sipas udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr 6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e tavaneve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021” dhe VKQ nr 33 datë 20.12.2017 “Për përgatitjen e buxhetit për vitin 2018” u bënë llogaritjet për transfertat e pakushtëzuara dhe të kushtëzuara. Ky udhëzim përcaktonte rritjen e transfertës së pakushtëzuar në vlerë, jo në përqindje si ishte llogaritur vitet e kaluara. Duke u mbështetur në këtë udhëzim u bënë llogaritjet për tre vitet në vazhdim për vitin 2019 transferta e pakushtëzuar është 38.474.467 lekë, për vitin 2020 transferta e pakushtëzuar është 39.276.018 lekë dhe për vitin 2021 transferta e pakushtëzuar është 40.077.570 lekë. Po ti konvertosh në përqindje këto vlera, rritja nga viti në vit është mesatarisht 2%.

Grupi diskutoi rreth buxhetit, burimeve financiare për tre vitet e ardhshme, të përbërë nga transferta e pakushtëzuar, të ardhurat e vet institucionit nga shërbimet që ofron dhe të ardhurat nga kuota e anëtarësisë. Pjesë e diskutimit ishin dhe projekt idetë për aktivitetet që do të planifikohen në vitet në vazhdim me synim arritjen e objektivave të Këshillit të Qarkut. Në lidhje me të ardhurat e veta GMS u mbështet në realizimin e të ardhurave të vitit 2017, si shërbimet që ofron K. Qarkut dhe të ardhurat nga kuota e anëtarësisë.

Programi	Emërtimi i të Ardhurave	Parashikimi për vitin 2019	Parashikimi për vitin 2020	Parashikimi për vitin 2021
01110	Të ardhurat e veta	12,323.640	12.570.113	12.821.515
01110	Transferta e pakushtëzuar	38.474.467	39.276.018	40.077.570
01160	Transferta të kushtëzuara DAMT	6.987.000	7,126.740	7.269.275
10430	Transferta të kushtëzuara Shërbimi Social	9.225.000	9.409.500	9.597.690
	Të ardhurat gjithsej	67.010.107	68.382.371	69.766.530

Për Këshillin e Qarkut mbetet prioritet “Zhvillimi dhe zbatimi i politikave rajonale në Qarkun Vlorë, në fushat ekonomike, turizmit, kulturës, shërbimit social, trashëgimisë kulturore, mjedisit etj, harmonizimi i tyre me politikat shtetërore në bashkëpunim me të shtatë Bashkitë e Qarkut dhe ushtrimi i funksioneve të deleguara”

Këshilli i Qarkut është në pritje të nënshkrimit të marrëveshjeve për zbatimin e gjashtë projekteve me fondet e Bashkimit European të cilat do jenë burime shtesë për realizimin e objektivave të institucionit.

Sfidat dhe risqet kryesore në realizimin e objektivave janë:

- Miratimi i fondit për shëbimin e qëndrave të kujdesit social nga Ministria përkatëse, i cili ka ardhur gjithmonë me vonesë.
- Ndjekja në vazhdimësi e procedurave gjyqësore, ankimimi i vendimeve në Gjykatën e Apelit dhe rekurs në Gjykatën e Lartë për të minimizuar detyrimet ndaj institucionit.
- Bashkëpunimi me bashkitë për realizimin e të ardhurave nga kuota e antarsisë, detyrimet e prapambetura, marrjen e angazhimeve të përbashkëta në projekte të ndryshme
- Mungesa e stafit të nevojshëm në realizimin e projekteve.

KRYETARI

Ervis Moçka